

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.G., nga Komuna e Obiliqit, për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1970/2014, të datës 13.12.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 10.02.2017, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**I.** Me aprovimin e pjesërishtë të ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, **ndryshohet**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1970/2014, të datës 13.12.2016, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit V.G., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPK, i shqipton dënimin me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë vepër të re penale, mbikëqyrjen e së cilës do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Prishtinë.

**II.** Në pjesët tjera aktgjykimi ngelë i pa ndryshuar.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1970/2014, të datës 13.12.2016, është shpallur fajtor i akuzuari, V.G., për shkak të veprës penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimin i shqiptuar me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €

Në kuptim të nenit 275 par 3 të KPK, të akuzuarit i është konfiskuar substanca narkotike e llojit kanabis (marihuan) që përmban tetrahidrokanabinol, në peshë prej 1.86 gr.

Është obliguar i akuzuari që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljes së ligjit penale, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi në përputhje me dispozitat ligjore.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.142/2017, të datës 02.02.2017, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e prokurorisë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje, ose i njëjti të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi në përputhje me dispozitat ligjore.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, e duke vlerësuar të gjitha shkresat e lëndës sipas detyrës zyrtare, ka gjetur se:

#### **Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, është e bazuar.**

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi ankimohet për shkak të shkeljeve të ligjit penal, të cilat shkelje manifestohen me rastin e marrjes së vendimit për dënimin si dhe shqiptimit të tij, ngase gjykata e shkallës së parë, ka tejkaluar kompetencën ligjore kur të akuzuarit për veprën penale posedimi i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 të KPK, i ka shqiptuar vetëm dënimin me gjobë, kurse për këtë lloj të veprës penale shprehimisht është e paraparë që kryesit ti shqiptohet dënimi kumulativ, sikurse është dënimi me gjobë dhe me burgim *“neni 275 par 1 të KPK- kushdo që pa autorizim posedon narkotik, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 1 (një) viti deri në 3 (tri) vite”*, kurse në rastin konkret dispozita ligjore nuk është aplikuar drejtë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesë së prokurorisë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet e ligjit penal, në kuptim të nenit 385 të KPPK, sepse qartë është e theksuar në dispozitën ligjore nga neni 275 par 1 të KPK, që kryerësit të veprës penale i cili shpallet fajtor për shkak të veprës penale në fjalë, duhet ti shqiptohet dënimi me gjobë dhe dënimi me burgim, kurse në rastin konkret rezulton se

gjkata e shkallës së parë ka bërë shkelje të ligjit penal në favor të akuzuarit, të cilin pasi që e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënimin me gjobë sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, ndërsa nuk e ka aplikuar drejtë dispozitën ligjore, sepse për këtë lloj të veprës penale duhet ti shqiptohet dënimi edhe me gjobë edhe me burgim, si dhe aktgjykimin e ka ndryshuar edhe lidhur me zbatimin e dënimit të shqiptuar me kusht, ashtu që sipas nenit 150 par 1 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, është caktuar se mbikëqyrjen do ta bëjë Shërbimi Sprovues në Prishtinë, e me ndryshimin e këtij aktgjykimi për vendimin për dënimin dhe ekzekutimin e saj është evituar edhe shkelja e ligjit penal.

Sa i përket vendimit për dënimin, përkundër asaj që në ankesë nuk ankimohet, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar të njëjtin dhe ka ardhur në përfundim se me aktgjykimin e ankimuar, janë bërë shkelje të ligjit penal, mirëpo duke zbatuar dispozitat ligjore, të njëjtat mangësi janë eliminuar, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sa i përket dënimit me burgim, duke e kushtëzuar të njëjtin dënim, sepse i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur qëndrim korrekt gjatë mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, se është penduar thellësisht për veprën e kryer penale, rrethana të tjera rënduese nuk ka gjetur, andaj, në prani të këtyre rrethanave e duke i vlerësuar ato ekzistueset që ndërlidhen me shkeljen e ligjit penal, intensitetin e kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën e kryerjes së të njëjtës, kolegji i kësaj gjykate është i bindur që me ndryshimin e aktgjykimit sikurse në dispozitiv dhe me dënimet e shqiptuara sikurse është dënimin me gjobë edhe ai me kusht do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Si u cek edhe më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi komfor nenit 403 të KPPK.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1. nr.119/2017 të datës 10.02.2017**

**Bashkëpunëtori profesional**  
**Hysni Ismaili**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Shqipe Qerimi**